



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, NR. 340/2015

Data 30.12.2015

Në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe në sajë të kërkesës së Koordinatorit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar që është në funksion të përmbushjes së kriterëve të mbetura për liberalizim të vizave, Këshilli Gjyqësor në takimin e jashtëzakonshëm të 144, të mbajtur me 30 dhjetor 2015, nxjerr këtë

V E N D I M

1. Të gjitha lëndët të shënuara me shenjen "LV", krahas numrit të rregullt, që vijnë nga prokuroritë e Republikës së Kosovës do të trajtohen me **PRIORITET ABSOLUT**.
2. Kryetarët e gjykatave duhet të ndërmarrin menjëherë masat për shpërndarjen e këtyre lëndëve, mundësisht brenda ditës, të gjyqtarët e gjykatës.
3. Me rastin e pranimit të lëndëve me shenjen "LV" nga ana e gjyqtarëve, gjyqtarët janë të obliguar që menjëherë të ndërmarrin veprimet e përcaktuara ligjore.
4. Gjyqtarët e ngarkuar me lëndët "LV" duhet menjëherë të kërkojnë nga SKGJK që të pajiset me kodin dhe shifrën në mënyrë që të i regjistrojnë të gjitha veprimet e ndërmarra në historikun e lëndëve (*tracking mechanism*).
5. Kryetari i gjykatës duhet të raportojë në KGJK në baza mujore në lidhje me lëndët e shënuara me "LV" duke përfshirë informacionet se sa lëndë të tilla janë pranuar, cilat veprime janë ndërmarrë, statusi i lëndëve, vetëm numrat e lëndëve etj. duke përjashtuar informacionet e ndjeshme përfaqëse emrat e të akuzuarve,.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Enver Peci,
Kryesues,
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimi i dërgohet:

- Kryetarëve të gjykatave
- MIE
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr. 341/2015
Datë: 30 dhjetor 2015

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mbështetur në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 20 të Ligjit me numër 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR TRANSFER TË PËRKOHSHËM

1. **Gjyqtari Elmaz Zenuni**, transferohet përkohësisht në afat kohor prej gjashtë (6) muaj duke filluar nga data 1 Janar 2016, nga Gjykata Themelore në Ferizaj në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për krime të rënda.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, departamenti për krime të rënda janë krijuar kushtet e jashtëzakonshme të punës në mungesë të gjyqtarëve në këtë departament.

Duke pasur parasysh rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara, Këshilli Gjyqësor i Kosovës për shkak të gjetjes së një zgjidhje të drejtë dhe ligjore vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Albert Avdiu, Drejtor, Sekretariati i KGJK-së
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr. 34212015
Datë: 30 dhjetor 2015

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mbështetur në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 20 të Ligjit me numër 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR TRANSFER TË PËRKOHSHËM

1. **Gjyqtari Valon Kurtaj**, transferohet përkohësisht në afat kohor prej gjashtë (6) muaj duke filluar nga data 1 Janar 2016, nga Gjykata Themelore në Prizren në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për krime të rënda.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, departamenti për krime të rënda janë krijuar kushtet e jashtëzakonshme të punës në mungesë të gjyqtarëve në këtë departament.

Duke pasur parasysh rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara, Këshilli Gjyqësor i Kosovës për shkak të gjetjes së një zgjidhje të drejtë dhe ligjore vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Albert Avdiu, Drejtor, Sekretariati i KGJK-së
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren



Këshilli Gjyqësor i Kosovës